

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7837
E mërkurë, 17 korrik 2024
Çmimi 0.50 €

Qeveria e Kosovës lanson projekt për investime nga mërgata



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

GJYKATA SPECIALE KA SHPALLUR VENDIMIN PËR ISH-EPRORIN E LARTË TË UÇK-SË, PJETËR SHALA

VAZHDON GJAHU I SPECIALES, KOMANDANT 'UJKU' DËNOHET ME 18 VJET BURGIM

- Gjykata Speciale në Hagë në emër të popullit dënon luftëtarët e UÇK-së, por duke u bazuar në dëshmi të pushtuesit serb



Ish-eprori i lartë i UÇK-së, Pjetër Shala, i njohur si komandant "Ujku", është dënuar nga Gjykata Speciale me 18 vjet burgim për, kinse, krime lufte. Ndaj këtij vendimi ka pasur reagime të shumta.


Udhëheqësi i veteranëve të UÇK-së, Faton Klinaku, e ka vlerësuar politik vendimin për Pjetër Shalën. Ai ka thënë se UÇK-ja ka luftuar kundër pushtuesit serb dhe për lirinë e popullit. "Gjykata Speciale

në Hagë në emër të popullit dënon luftëtarët e UÇK-së, por duke u bazuar në dëshmi të pushtuesit serb e me dëshmi të dëshmitarëve të fshehur nga populli", ka thënë Klinaku f

SZUNYOG: DRAFTI I ASOCIACIONIT DUHET TË DËRGOHET NË KUSHTETUESE, TRE KRERËT E SHTETIT PREMTUAN THEMELIMIN F.3



AGK-ja I KËRKON PRESIDENTES QËNDRIM PUBLIK PËR LIGJIN E KPM-së F.6



RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
E-mail: renova@mt.net.mk
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



TRUMPI ZYRTARISHT KANDIDAT I REPUBLIKANËVE PËR PRESIDENT, VANCE PËR ZËVENDËSPRESIDENT F.2

KONSTITUOHET PE-ja, METSOLA RIZGJIDHET KRYETARE F.5

BE-JA NDAN 13 MILIONË EURO PËR USHTRINË E SHQIPËRISË DHE FORCIMIN E SIGURISË NË RAJON F.3

EKONOMI



KESCO IMPORTON 1 MILION EURO ENERGJI ELEKTRIKE NË DITË F.8

KRIJOHET FONDI I PËRBASHKËT PËRSHPEJTUES I OBJEKTIVAVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM PËR KOSOVËN F.8

SPORT



EKIPI OLIMPIK I KOSOVËS PRANON FLAMURIN SHTETËROR PËR LOJËRAT OLIMPIKE PARIS 2024 F.10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Trumpi zyrtarisht kandidat i republikanëve për president, Vance për zëvendës-president

WASHINGTON, 16 KORRIK - Ish-presidenti amerikan Donald Trump, i cili do të garojë sërish në zgjedhjet presidenciale të nëntorit, zgjodhi senatorin e Ohajos, J. D. Vance, kandidat për zëvendës-president. Ai e ka bërë njoftimin në ditën e parë të Konventës së Republikanëve, në Milluaki të Viskonsinit, dhe pak pas sulmit ndaj tij në Pensilvani, si pasojë e të cilit Trumpi është plagosur në vesh, ndërsa një mbështetës i tij në publik është vrarë.

Trumpi e ka bërë të ditur përzgjedhjen e tij në platformën e vet sociale "Social Truth".

W. Joseph Campbell, profesor i komunikimeve në Universitetin Amerikan, thotë për "Radion Evropë e Lirë" se Vance ka qenë shumë kritik ndaj ndihmës së ShBA-së për Ukrainën dhe se zgjedhja e tij dërgon një sinjal për politikën që mund t'i ndjekë Trumpi ndaj Ukrainës nëse fiton. Campbell thotë se zgjedhja e Vances - edhe pse ka qarkulluar si emër - ishte e befasishme, për faktin se ai ishte kritik i Trumpit. Trumpi u konfirmua të hënën

zyrtarisht kandidat i Partisë Republikane në zgjedhjet e 5 nëntorit. Kundërkandidat i tij do të jetë presidenti aktual i ShBA-së, Joe Biden. "Sipas meje, Trumpi mendon se kjo është një zgjedhje brezash, që duke zgjedhur dikë kaq të ri në krahasim me veten - meqë ai është në fund të të 70-tave - programi MAGA (Ta bëjmë Amerikën sërish të madhe) që Trumpi ka përkrahur nga viti 2015, do të vazhdojë të jetojë edhe pas largimit të tij nga skena politike. Vance është një zgjedhje jofrymëzuese, meqë është një senator i ri. Ai vjen nga shteti i Ohajos, i cili është bërë shumë më i kuq [v.j. më republikan] në ciklet e fundit zgjedhore. Unë nuk jam i sigurt se ai e ndihmon shumë Trumpin në Ohajo, apo nëse ka efekt të përhapur në shtetet e tjera si Pensilvania ose Miçigjeni, që kufizohen me Ohajon. Ato janë shtete shumë të rëndësishme për sa i përket kolegjit zgjedhor, por nuk mendoj se votuesit e pavarur e të pavendosur do ta shohin këtë përzgjedhje si shumë frymëzuese. Për mua, zgjedhje më e mirë do të ishte Glenn



Youngkin, guvernator i Virxhinias, i cili është në detyrë tash e disa vjet. Ai edhe do ta ndihmonte Trumpin në atë shtet. Youngkin nuk është 39 vjeç, por nuk është as i vjetër. Kështu që unë mendoj se do të ishte një zgjedhje më e mirë në përgjithësi", ka theksuar Campbell, duke shtuar se emri i Vances ka qarkulluar për kohë të gjatë si një nga kandidatët e mundshëm për zëvendës-president andaj, sipas tij, nuk është emër i ri dhe nuk është befasi e madhe. "Por, unë, gjithashtu mendoj, se Vance është

dikush që është paksa i paparashikueshëm - të paktën në të kaluarën e tij të afërt. Ai nuk ka qenë mbështetës i Trumpit kur Trumpi ka hyrë në garë në vitin 2016, për shembull. Madje, mendoj se ai ka deklaruar se nuk do të jetë kurrë mbështetës i tij. Kjo e kaluar e tij mendoj se e bën këtë zgjedhje paksa befasuese, sepse Donald Trumpi është dikush që mban mëri. Ai dihet se mban mëri me vite të tëra", ka deklaruar ai. Campbell ka pohuar se Zelensky do të jetë shumë i shqetësuar për

këtë zgjedhje. "Vance nuk ka një vlerësim të lartë për vazhdimin e ndihmës për Ukrainën. Dhe kjo duhet të jetë pak shqetësuese, sepse mund të sinjalizojë atë që Trumpi e mendon në të vërtetë për ndihmën për Ukrainën, nëse ai e fiton presidencën. Por, sigurisht, amerikanët në përgjithësi janë më nervozë për luftën në Ukrainë. Ajo vazhdon për më shumë se dy vjet dhe po arrin në një pikë ku njerëzit po pyesin: për çfarë po i shpenzojmë gjithë këto para dhe çfarë po marrim në këmbim? Pra, Vance është disi në këtë kamp, dhe do të jetë një shqetësim i vërtetë - jam i sigurt - për disa liderë evropianë, sidomos Zelenskyn. Nuk mendoj se Vance ka kredenciale të mëdha të politikës së jashtme por, në fakt, kjo nuk është kërkesë për një kandidat për zëvendës-president. Duhet të kthehemi prapa në histori për të gjetur një kandidat për nën-president, i cili ka qenë vërtet i përfshirë në politikën e jashtme. George H. W. Bush për Ronald Reaganin në vitet '80 ka qenë një shembull, ndoshta", ka thënë Campbell.

Bideni mbron retorikën e tij kundër Trumpit



WASHINGTON, 16 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, mbrojti retorikën e tij kundër ish-presidentit Donald Trump, në intervistën e tij të parë që nga atentati kundër këtij të fundit në fundjavë.

Bideni dhe Trumpi do të përballen në zgjedhjet presidenciale të nëntorit.

Duke folur për NBC-në, Bideni tha se fushata e tij e ka për detyrë të flasë hapur për kërcënimet që do t'i sillte një mandat i dytë i Trumpit dhe shtoi se fjalët e tij nuk janë ato që duhet të zbuten. Megjithatë, ai

tha se ka qenë "gabim" që ka thënë se është "koha për ta vënë Trumpin në qendër të objektivit". Sipas raportimeve nga "Politico", Bideni i bëri këto komente në një bashkëbisedim me disa donatorë, disa ditë përpara atentatit kundër Trumpit, në një tubim në Pensilvani më 13 korrik.

Në intervistën dhënë NBC-së, Bideni tha se me këtë ka menduar që demokratët e tij duhet të fokusohen më shumë te Trumpi, politikën e tij dhe deklaratat e rreme që ka bërë gjatë një debati presidencial muajin e kaluar.

Gjatë intervistës, Bideni bëri të qartë se nuk do të tërhiqet nga gara presidenciale pavarësisht prej thirrjeve të disa anëtarëve të partisë së tij për ta bërë këtë, për shkak të performancës së tij të dobët në atë debat. "Unë e kuptoj përse njerëzit thonë: Zot, ai është 81 vjeç. Ua! Çfarë do të bëhet kur të jetë 83 vjeç, 84 vjeç?... Është një pyetje legjitime që bëhet", tha Bideni.

Ai shtoi se u beson votuesve që e mbështetën atë në zgjedhjet paraprake demokrate. "Unë i dëgjoj ata", tha Bideni.

Zbulohet një shpellë në Hënë

WASHINGTON, 16 KORRIK - Shkencëtarët kanë konfirmuar zbulimin e një shpelle në Hënë, jo larg vendit ku Neil Armstrong dhe Buzz Aldrin u ulën 55 vjet më parë. Shkencëtarët mendojnë se në Hënë ka qindra shpella të tjera ku mund të strehohen astronautët në të ardhmen.

Një ekip i udhëhequr nga shkencëtarë italianë njoftoi të hënën se ka prova për një shpellë të përmasave të mëdha, hyrja e së cilës është në atë që njihet si gropa më e thellë në Hënë dhe shtrihet në "Detin e Qetësisë" "Sea of Tranquility", rreth 400 kilometra nga vendi ku u ul misioni 'Apollo 11'.

Ultësira, me rreth 200 të tjera të ngjashme të zbuluara atje, është krijuar nga shembja e tubacioneve të llavës, sipas shkencëtarëve.

Hulumtuesit analizuan matjet e radarëve nga sonda "Lunar Reconnaissance Orbiter" që vëzhgon Hënë dhe i krahasuan rezultatet me damarët e llavës në tokë. Studimi i tyre është publikuar në revistën "Nature Astronomy".

Të dhënat e radarit tregojnë vetëm pjesën fillestare të zgavrës hënore, sipas shkencëtarëve. Ata vlerësojnë se shpella është të paktën 40 metra e gjerë dhe disa dhjetëra metra e gjatë, ndoshta



më shumë. "Shpellat hënore kanë qenë mister për më shumë se 50 vjet. Kështu që ishte emocionuese prova e ekzistencës së një shpelle",

thanë përmes një emali Leonardo Carrer dhe Lorenzo Bruzzone nga Universiteti i Trentos. Shumica e gropave duket se

ndodhen në fushat e lashta të llavës së Hënës, sipas shkencëtarëve. Astronautët nga NASA kanë në plan që në fund të kësaj dekade të zbrisin në polin jugor të Hënës, ku mund të ketë gropa të ngjashme. Besohet se ka akuj në krateret hënore që nuk ndriçohen kurrë nga dielli, që mund të shfrytëzohen për ujë të pijshëm dhe lëndë djegëse për raketat.

Gjatë programit Apollo të NASA-s, 12 astronautë u ulën në Hënë, duke filluar me Armstrongun dhe Aldrinin më 20 korrik të vitit 1969. Gjetjet sugjerojnë se mund të ketë qindra gropa në Hënë dhe mijëra tubacione llave.

BE-ja ndan 13 milionë euro për ushtrinë e Shqipërisë dhe forcimin e sigurisë në rajon

PRISHTINË, 16 KORRIK - Këshilli Evropian miratoi të hënën një paketë ndihme prej 13 milionë eurosh për ta mbështetur ushtrinë e Shqipërisë. Lajmi u bë me dije nga Zyra e Bashkimit Evropian në Tiranë, e cila e cilësoi vendimin arritje historike për Shqipërinë.

Fondi është ndarë për t'i mbështetur forcat e armatosura shqiptare në kuadër të Mekanizmit Evropian të Paqes. "Kjo nismë synon t'i forcojë aftësitë ushtarake të Shqipërisë dhe ta rrisë sigurinë rajonale", tha Zyra e Bashkimit Evropian në Tiranë.

Përmes një postimi në platformën "X", zyra e BE-së tha se ndihma ka për qëllim rritjen e efektivitetit operacional të lëvizshmërisë, manovrimit dhe mbrojtjes. Sipas saj, këto fonde do ta forcojnë kapacitetin e Shqipërisë në lidhje me pjesëmarrjen e saj në operacionet dhe misionet e politikës së përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së, si dhe në çdo koalicion ndërkombëtar.

Kryediplomati në shkuarje i BE-së, Joseph Borrell, ka deklaruar se

Shqipëria është partnere e besueshme për siguri. "Vendimi është një arritje e rëndësishme në bashkëpunimin tonë për sigurinë dhe mbrojtjen. Gjithashtu, pasqyron vlerësimin tonë për qëndrimin e Shqipërisë në linjë të plotë me politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes të BE-së, një shprehje shumë e qartë e zgjedhjes strategjike të Shqipërisë për një të ardhme brenda BE-së", ka thënë Borrell.

Në kuadër të Mekanizmit Evropian të Paqes, Shqipëria do të sigurojë pajisje që nuk janë projektuar për të prodhuar forcë eliminimi fizik dhe, aty ku nevojitet, furnizime dhe shërbime të tjera, përfshirë trajnim teknik.

Forca tokësore shqiptare do të pajisjet me mjete të lehta të blinduara shumëfunksionale, për të siguruar lëvizshmëri dhe manovrim të lartë në të gjitha llojet e terrenit dhe, pavarësisht prej kushteve të motit, si dhe për ta siguruar mbrojtjen e personelit ndaj armëve të lehta dhe eksplozivëve.

Rreth tre muaj më parë Ministria



e Mbrojtjes në Shqipëri ka hartuar strategjinë ushtarake 2024-2033, sipas së cilës, deri në vitin 2033 në radhët e ushtrisë shqiptare të shërbejnë mbi 9 500 veta, nga rreth 6 mijë e 500 sa janë aktualisht.

Gjatë samitit të mbajtur në Uashington ditë më parë, për 75-vjetorin e NATO-s, Shqipëria ka nënshkruar një marrëveshje për

sigurimin dhe lehtësimin e lëvizjes ushtarake përgjatë Korridorit VIII Pan-Evropian, së bashku me Italinë, Bullgarinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Nënshkrimi i marrëveshjes konsiderohet mbështetje drejt vizionit që ka Shqipëria për Korridorin VIII si dhe të projektit për ndërtimin e Bazës Detare të NATO-s në Porto Romano, që do

të shërbejë si porta kryesore hyrëse në Ballkanin Perëndimor dhe më tej, në Detin e Zi.

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi, pati thënë në qershor se Shqipëria është e vendosur për t'i transformuar forcat dhe kapacitetet ushtarake. Sipas tij, deri në vitin 2030 Shqipëria do të hyjë në tregun ndërkombëtar me produktet "Made in Albania".

Szunyog: Drafti i Asociacionit duhet të dërgohet në Kushtetuese, tre krerët e shtetit premtuan themelimin

PRISHTINË, 16 KORRIK - Shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog, në një intervistë për "Ekonomia Online", ka thënë se themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe është obligim ndërkombëtar dhe ligjor i Kosovës, për të cilin vendi ka bërë marrëveshje në vitin 2013 dhe se është ratifikuar edhe nga Kuvendi i Kosovës me shumicë kushtetuese. Ai ka thënë se BE-ja ka propozuar draftin për Asociacionin, për të cilin ka treguar se kryeministri Albin Kurti ishte i gatshëm ta nënshkruante dhe ta pranonte në tetor të vitit të kaluar.

Szunyog ka theksuar se ky draft respekton vijat e kuqe të të dyja palëve dhe se duhet të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese. "E pra, përsëri, Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe është obligim i Kosovës, që nuk është diçka e re.



Për themelimin e tij tashmë është rënë dakord në vitin 2013. Fjala vjen, kjo marrëveshje është ratifikuar edhe nga Kuvendi i

Kosovës me shumicë kushtetuese. Pra, nga ky këndvështrim, është obligim ndërkombëtar i Kosovës, por

është obligim ligjor vendor ta themelojë Asociacionin. Ne kemi propozuar si Bashkim Evropian një draft. Kryeministri Kurti ishte i gatshëm ta pranonte këtë draft dhe ta nënshkruante tetorin e kaluar. Pra, nga ky këndvështrim, besojmë se ky është një draft i mirë, që respekton vijat e kuqe të të dyja palëve. Dhe ne besojmë se duhet marrë dhe dërguar në Gjykatën Kushtetuese në atë mënyrë që të jetë i pranueshëm dhe Gjykata Kushtetuese mund të vendosë për këtë", ka thënë Szunyog.

Ambasadori i BE-së në Kosovë ka thënë se të tre krerët e shtetit, presidentja Vjosa Osmani, kryeministri Albin Kurti dhe kryeparalmetari Glauk Konjufca, kanë premtuar themelimin e Asociacionit në letërën e përbashkët të nënshkruar nga ta dërguar Këshillit të Evropës. Për

këtë, ai ka thënë se Asociacioni duhet themeluar dhe sa më shpejt të bëhet kjo, sipas tij, aq më mirë do të jetë për përparimin e Kosovës në rrugën për t'u bërë anëtare e BE-së. "Por përsëri ky është vetëm hapi i parë në procesin e themelimit të Asociacionit. Dhe përsëri, mirëkuptimi im është, gjithashtu, se në këtë letër të përbashkët të nënshkruar nga presidentja, kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, dërguar Këshillit të Evropës majin e kaluar, tre liderët kushtetues të Kosovës premtuan themelimin e Asociacionit. Kështu që unë mendoj se kjo është diçka që duhet bërë. Sa më shpejt të bëhet kjo, aq më mirë për përparimin e Kosovës në rrugën për t'u bërë anëtare e BE-së", ka thënë shefi i Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomas Szunyog.

Haxhiu pret në takim drejtorin e Akademisë të së Drejtës Evropiane, flasin për anëtarësimin e Kosovës në ERA

Prishtinë, 16 korrik - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka pritur në takim drejtorin e Akademisë të së Drejtës Evropiane (ERA), Jean Philippe Regarde, dhe drejtorin e Akademisë së Drejtësisë së Kosovës, Enver Fejzullahu. Gjatë këtij takimi është diskutuar për bashkëpunimin ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, ERA-s

dhe Akademisë së Drejtësisë së Kosovës.

Një nga temat kryesore të diskutimit ishte mundësia e anëtarësimit të Kosovës në ERA, një hap i rëndësishëm për fuqizimin e sistemit të drejtësisë në vendin tonë.

Më tutje në takim është diskutuar për mundësinë e përfundimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve të

Kosovës nga programet trajnuese të ERA, gjithashtu edhe për trajnimin e tyre për të drejtën dhe standardet evropiane.

Ministria Haxhiu theksoi rëndësinë e vazhdimin dhe thellimit të këtij bashkëpunimi për përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe ngritjen e standardeve të drejtësisë në Kosovë.





GJYKATA SPECIALE KA SHPALLUR VENDIMIN PËR ISH-EPRORIN E LARTË TË UÇK-SË, PJETËR SHALA

Vazhdon gjahu i Speciales, komandant 'Ujku' dënohet me 18 vjet burgim

- Gjykata Speciale në Hagë në emër të popullit dënon luftëtarët e UÇK-së, por duke u bazuar në dëshmi të pushtuesit serb

Ish-eprori i lartë i UÇK-së, Pjetër Shala, i njohur si komandat "Ujku", është dënuar nga Gjykata Speciale me 18 vjet burgim për, kinse, krime lufte. Ndaj këtij vendimi ka pasur reagime të shumta. Udhëheqësi i veteranëve të UÇK-së, Faton Klinaku, e ka vlerësuar politik vendimin për Pjetër Shalën. Ai ka thënë se UÇK-ja ka luftuar kundër pushtuesit serb dhe për lirinë e popullit. "Gjykata Speciale në Hagë në emër të popullit dënon luftëtarët e UÇK-së, por duke u bazuar në dëshmi të pushtuesit serb e me dëshmi të dëshmitarëve të fshehur nga populli", ka thënë Klinaku

Çfarë tha kryetarja e trupit gjykues?

Kryetarja e trupit gjykues në rastin e Pjetër Shalës, Mappie Veldt-Foglia, ka thënë se fabrika e dikurshme e metalit në Kukës është përdorur prej UÇK-së - në periudhën maj 1998 deri në qershor 1999 - për rekrutim dhe logjistikë, mes të tjerash. Ajo ka

thënë se gjykata ka marrë dëshmi të besueshme se ky objekt është përdorur për të ndaluar, marrë në pyetje dhe keqtrajtim të njerëzve që dyshohej se bashkëpunonin apo simpatizonin autoritetet serbe, apo nuk përkrahnin mjaftueshëm përpjekjet e UÇK-së. "Shala ka marrë pjesë në transferimin nën rojë të njërit prej të ndaluarve në fabrikë, ka

marrë pjesë në marrje në pyetje dhe keqtrajtim të të ndaluarve, së bashku me anëtarë të tjerë të UÇK-së. Shala ka qenë i pari që ka goditur disa të ndaluar. Njëri prej të ndaluarve tha se Shala e ka goditur me shkop bejsbolli dhe e ka akuzuar se ishte spiun", ka thënë ajo.

Numri i të ndaluarve nuk dihet, por vlerësohet të ketë qenë rreth 40 persona, përfshirë tri gra, ka thënë gjykatësja. "Trupi gjykues i ka identifikuar 18 persona... ka dëgjuar dëshmi të dorës së parë për ngjarjet traumatike të përjetuara gjatë ndalimit të tyre në këtë fabrikë dhe ndikimin që kanë pasur këto ngjarje në jetën e tyre dhe të familjeve të tyre", ka thënë Veldt-Foglia.

Trupi gjykues ka thënë se të ndalurit janë mbajtur në rrethana çnjerëzore. "Atyre nuk u është dhënë ushqim dhe ujë. Një dëshmitar kujtoi se nganjëherë dy të ndaluar ndanin një vezë të zier. Të ndaluarve nuk u lejohej të pastroheshin. U duhej të kërkonin leje të përdornin banjën, që ishin në gjendje të keqe. Dëshmitarët kanë thënë se në atë gjendje 'as kafshët nuk do të jetonin'", ka thënë ajo.

Veldt-Foglia ka thënë se të ndaluarit janë rrahur dhe janë detyruar ta rrahin njëri-tjetrin, u

Dënimi i Pjetër Shalës, Murati: Edhe një përpjekje për goditjen e UÇK-së

Kryetari i Lëvizjes për Bashkim, Valon Murati, ka reaguar pas aktgjykimit të Gjykatës Speciale ndaj Pjetër Shalës, i cili është dënuar me 18 vjet burgim. Sipas Muratit, kjo është edhe një përpjekje për goditjen e UÇK-së. "Dhomat e Specializuara në Hagë sot dënuan bashkëluftëtarin Pjetër Shalën me 18 vite burgim. Edhe një përpjekje për goditjen e UÇK-së dhe kontribuuesve të luftës çlirimtare. Dhe përderisa këto dënime të padrejta po bien mbi barrën e të dënuarve

padrejtësisht dhe familjeve të tyre, UÇK-ja dhe lufta çlirimtare e popullit shqiptar për çlirimin e Kosovës, kaqerë kanë kaluar gjykimin e gjykatës së historisë. Gjeneratat e ardhshme do të jetojnë me lavdinë e kësaj lufte për liri dhe krenar me vlerësimin e gjykatës së përjetshme asaj të historisë njerëzore, paçka që ne po duhet të jetojmë në kohën e kësaj gjykate të përkohshme absurde qoftë në planin juridik, e po ashtu në atë politik", ka shkruar Murati në "Facebook".

EPOKA ERE

Lirim GECI

HAGË, 16 KORRIK - Ish-eprori i lartë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) është dënuar të martën me 18 vjet burgim për krime lufte nga trupi gjykues i Gjykatës Speciale. Shala, i njohur si komandant "Ujku", është shpallur fajtor për ndalim arbitrar dhe torturë kundër së paku 18 personave dhe në pikën e vrasjes së paligjshme kundër një personi, më ose rreth datës 5 qershor 1999, në fabrikën e metalit në Kukës të Shqipërisë. Gjykata Speciale ka thënë se akuzat e trajtimit mizor është mbuluar tërësisht nga ajo e torturës dhe nuk është shqyrtuar më tej nga Gjykata.

Sipas gjykatës, viktimat kanë qenë kryesisht shqiptarë të Kosovës, të cilat kanë pësuar dëme nga shqiptarë të tjerë të Kosovës. "Dëshmitë e tyre kanë të gjalla, të hollësishme dhe bindëse", është thënë në vendim.

Prokuroria ka kërkuar dënim prej 28 vjetësh për Shalën. Pjetër Shala, shtetas belg, është deklaruar më parë i pafajshëm për të gjitha akuzat. Gjykata Speciale funksionon sipas ligjeve të Kosovës dhe aktualisht heton krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000.

Mosrespektimi i vullnetit të votuesve, Ali Ahmeti angazhon ekip ndërkombëtar në krye me autorin e marrëveshjes së Ohrit

SHKUP, 16 KORRIK - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka angazhuar ekip ndërkombëtar, përmes të cilit do të kërkojë zgjidhje për mosrespektimin e vullnetit të votuesve, pasi që "Fronti Evropian", që drejtohet nga Ahmeti, ndonëse i ka fituar zgjedhjet në taborin shqiptar, është lënë jashtë qeverisë së Maqedonisë së Veriut. Lajmin e ka bërë me dije nënkryetari i BDI-së, Arbër Ademi, i cili ka njoftuar se në krye të këtij ekipi do të jetë Paul William, autor i marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001, e cila i kishte dhënë fund luftës në mes të

forcave ushtarako-policore maqedonase dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) me komandat suprem Ali Ahmetin, e cila kishte filluar për shkak të dhunës dhe represionit të vazhdueshëm që regjimi maqedonas ua bënte shqiptarëve. "Ekipi është duke punuar në disa ide të propozuara për të pamundësuar mosrespektimin e vullnetit të votuesve në të ardhmen dhe shkeljen e frymës së Marrëveshjes së Ohrit, duke theksuar se esenca e Marrëveshjes së Ohrit është të parandalojë sundimin e shumicës (majorizimin) mbi komunitetin e dytë më të madh në vend, duke

promovuar kështu një demokraci të vërtetë multietnike dhe konsensuale", ka shkruar Ademi në "Facebook".

E gjithë kjo lëvizje e Ahmetit ka ardhur pasi që lideri nationalist i VMRO-DPMNE-së, tashmë edhe kryeministër i Maqedonisë së Veriut, Hristjan Mickoski, la jashtë qeverisë fituesin e zgjedhjeve parlamentare të 8 majit në taborin shqiptar, pra "Frontin Evropian". Me këtë veprim, Mickoski ka shkelur parimin e fituesit me fituesin (te kampi shqiptar dhe ai maqedonas), duke zgjedhur koalicionin "VLEN", i cili në zgjedhje mori katër deputetë më pak se "Fronti Evropian" (18-14).



Konstituohet PE-ja, Metsola rizgjidhet kryetare



STRASBURG, 16 KORRIK - Përbërja e re e Parlamentit Evropian u konstituua të martën.

Ajo doli nga zgjedhjet që u mbajtën në të 27 vendet e Bashkimit Evropian nga data 6 deri më 9 qershor.

Në krye të PE-së u rizgjidh malteza Roberta Metsola, e cila do ta drejtojë këtë institucion edhe për dy vjet e gjysmë.

Metsola vjen nga vendi më i vogël në BE. Ajo u zgjodh për herë të parë në janar të vitit 2022, pas vdekjes së paraardhësit të saj David Sassoli. Për Metsolën votuan 562 përfaqësues evropianë.

Kjo është përbërja e dhjetë e

Parlamentit Evropian, i cili ka 720 deputetë. Prej tyre, 54 për qind janë emra të rinj, ndërsa 39 për qind janë gra. "Na duhet të ngrihem dhe të jemi gati. Në mandatin e fundit mësuam se e ardhmja nuk është asgjë tjetër veçse e paparashikueshme", tha Metsola gjatë një fjalimi përpara deputetëve evropianë. "Kjo duhet të jetë një shtëpi që nuk mund të ketë frikë për të udhëhequr dhe për të ndryshuar. Ne kemi filluar, por nuk kemi mbaruar ende", tha ajo. Metsola bëri thirrje edhe për mbrojtje të fortë të sundimit të ligjit, mbështetje të vazhdueshme për Ukrainën, paqe të

qëndrueshme në Lindjen e Mesme, thjeshtësim të burokracisë dhe mbrojtje më të fortë të të drejtave sociale.

Deputetët evropianë janë të vetmit përfaqësues në institucionet e BE-së që zgjidhen drejtpërdrejt nga populli.

Ndër detyrat e para të përbërjes së re të PE-së do të jetë zgjedhja e presidentit të Komisionit Evropian. Ursula van der Leyen synon rizgjedhjen dhe qeveritë e BE-së kanë rënë dakord tashmë për emrin e saj. Megjithatë, emërimi duhet të konfirmohet nga PE-ja. Votimi për von der Leyenin është caktuar për datën 18 korrik.

Kurti takon ambasadorin suedez: Anëtarësimi në NATO, synim i qartë i Kosovës

Prishtinë, 16 korrik - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim ambasadorin e Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, shefin e SIDA-s në Kosovë, Henrik Riby, dhe përfaqësuesin e organizatës Grupi Ballkanik për Hulumtim të Politikave, Naim Rashiti. Kryeministri Kurti e uroi ambasadorin Westerlund

për fillimin e mbarë të anëtarësisë së Suedisë në NATO, ndërkohë që theksoi se anëtarësimi i Kosovës në po këtë organizatë mbetet synim i qartë dhe angazhim i vazhdueshëm i institucioneve të Republikës së Kosovës.

Kryeministri Kurti e falënderoi ambasadorin Westerlund për përkrahjen ndaj Kosovës në procesin e

integriteteve evropiane dhe për ndihmën e dhënë për shumë projekte zhvillimore, përfshirë këtu projektin "Ndërtimi i Paqes dhe Avancimi i Agjendës Evropiane", që menaxhohet nga Grupi Ballkanik për Hulumtim të Politikave/BPRG, e i cili mbështet një numër ekspertësh ndërkombëtarë dhe vendorë.



janë thyer dhëmbët dhe gjymtyrët, dhe se kanë jetuar në frikë të vazhdueshme. "Ata janë ngacmuar dhe kërcënuar me dhunë deri në vdekje", ka thënë ajo.

Shala është arrestuar më 16 mars 2021 në Belgjikë dhe është transferuar në objektin e Gjykatës Speciale në Hagë të Holandës më 15 prill 2021.

Në dënim do të përfshihet edhe periudha e paraburgimit. Gjyqi ndaj Shalës ka nisur në shkurt të vitit 2023. Ky është aktgjykimi i dytë i kësaj gjykate lidhur me hetimet për krime lufte.

Ish-komandanti i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Salih Mustafa, është dënuar në dhjetor të vitit 2022 me 26 vjet burgim

për krime lufte. Më vonë Apeli ia ka ulur dënimin në 22 vjet burgim.

Më herët nga Dhomat e Specializuara në Hagë janë dënuar ish-krerët e Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, për pengim të administrimit të drejtësisë, por më pas janë liruar me kusht.

Përveç Mustafës dhe Shalës, të akuzuar për krime lufte janë edhe ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kreu i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Rexhep Selimi, dhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi. Gjyqi ndaj tyre është duke vazhduar.

Udhëheqësi i veteranëve të UÇK-së: Vendimi për dënimin e Pjetër Shalës, politik

Ndaj vendimit të Gjykatës Speciale për Pjetër Shalën ka pasur reagime të shumta në Kosovë. Ushtruesi i detyrës së kryetarit të OVL-UÇK-së, Faton Klinaku, ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës Speciale për dënimin e Shalës është politik. Klinaku ka shkruar në "Facebook" se UÇK-ja ka luftuar kundër pushtuesit serb dhe për lirinë e popullit. "Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka luftuar kundër pushtuesit serb dhe për lirinë e popullit. Gjykata Speciale në Hagë në emër të popullit dënon luftëtarët e UÇK-së, por duke u bazuar në dëshmi

të pushtuesit serb e me dëshmi të dëshmitarëve të fshehur nga populli. Ashtu sikur në aktgjykimet e kaluara, edhe në rastin e bashkëluftëtarit Pjetër Shala, Gjykata Speciale aktgjykimet i merr politikisht", ka shkruar Klinaku.

Bashkëshortja e Rexhep Selimit: Qëndro i fortë Pjetër Shala, Gjykata Speciale është politike

Ndërsa deputetja Shqipe Mehmeti-Selimi, bashkëshortja e Rexhep Selimit, ka vlerësuar se pretendimi i Gjykatës Speciale, se UÇK-ja është "ndërmarrje e përbashkët kriminale", është i

pafalshëm dhe denigruar për popullin e Kosovës. Sipas deputetes së Vetëvendosjes, UÇK-së nga askush nuk mund t'i vihet emër tjetër përveç atij që i dha populli i Kosovës. "Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës asnjëherë dhe nga askush nuk mund t'i vihet emër tjetër përveç atij që i dha populli i Kosovës. Pretendimi i Gjykatës Speciale, se UÇK-ja është 'ndërmarrje e përbashkët kriminale', është e pafalshme dhe denigruar për popullin e Kosovës. Kjo dëshmon se kjo gjykatë është politike dhe kundër vlerave tona njerëzore dhe demokratike. Qëndro i fortë Pjetër Shala!", ka shkruar Mehmeti-Selimi në "Facebook".

Latifi pret në takim përfaqësuesit e KQZ-së, diskutojnë për zgjedhjet qendrore dhe komunale

RAHOVEC, 16 KORRIK - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka pritur në takim përfaqësuesit e Komisionit Qendror Zgjedhor, Burim

Ahmetaj, Ibrahim Selmanaj dhe Arjanit Elshani. Ai ka bërë me dije se në frymën e bashkëpunimit ndërinstitucional, diskutuan për

mbështetjen e komunës së Rahovecit për ofrimin e infrastrukturës dhe të logjistikës së nevojshme për KQZ-në, për organizimin e zgjedhjeve

qendrore e komunale. "Komuna e Rahovecit ka ofruar dhe do të ofrojë të gjithë mbështetjen e kërkuar", ka thënë kryetari Latifi.




IKShPK-ja u bënë thirrje qytetarëve të kenë kujdes nga ushqimi

PRISHTINË, 16 KORRIK - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës (IKShPK) përmes një njoftimi ka kërkuar nga qytetarët të kenë kujdes për sigurinë e ushqimit gjatë temperaturave të larta. IKShPK-ja njofton se në ditët me temperatura të larta është shumë e rëndësishme të kujdesemi për sigurinë e ushqimit që e konsumojmë. "Në ditët me temperatura të larta, është shumë e rëndësishme që të kujdesemi për sigurinë e ushqimit që e konsumojmë. Përmes ruajtjes dhe përgatitjes adekuate të ushqimit, mund të parandalojmë rritjen e baktereve; ruajmë freskinë e

ushqimit; shmangim helmimet përmes ushqimit; i ruajmë vlerat ushqyese të tij dhe mundësojmë të zgjatet afati i përdorimit të ushqimit. Kujdesi për sigurinë e ushqimit gjatë verës nuk është vetëm një zakon i mirë, por një nevojë për shëndetin dhe mirëqenien tuaj. Për më shumë informacion, ndiqni këshillat në foto: 5 çelësat për ushqim të sigurt, një udhëzues ky i Organizatës Botërore të Shëndetësisë për sigurinë e ushqimit që për qëllim ka parandalimin e sëmundjeve të shkaktuara nga ushqimet e kontaminuara", ka njoftuar IKShPK-ja.

AGK-ja i kërkon presidentes qëndrim publik për Ligjin e KPM-së

PRISHTINË, 16 KORRIK - Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës ka njoftuar se po ndjek me interesim reagimet pas miratimit javën e kaluar të Ligjit për KPM-në nga shumica parlamentare në Kuvendin e Kosovës.



Shqetësimeve të AGK-së i janë bashkuar Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Misioni i OSBE-së në Kosovë, si dhe shumë prej përfaqësive të huaja diplomatike në Kosovë, duke vënë në pah që ligji nuk është në pajtim me standardet e Këshillit të Evropës.

AGK-ja kërkon nga presidentja e Republikës së Kosovës, zonja Vjosa Osmani, që të formojë qëndrim rreth këtij ligji dhe ta ndajë atë me publikun dhe të mos kufizohet vetëm në rolin e saj formal i dekretrimit të ligjeve. "Mediat e lira dhe pluralizmi medial janë gurëthemeli i një shoqërie demokratike dhe kur ky themel fillon të lëkundet seriozisht atëherë Presidentja e shtetit ka për obligim që të deklarohet publikisht. Nga presidentja pritet që të deklarohet publikisht dhe të ndërveprojë me institucionet e tjera vendimmarrëse në mbrojtje të lirisë së medias dhe shtypit si bazament i një demokracie të shëndoshë të një shteti që aspiron integrimin në BE", është thënë në njoftimin e AGK-së.

Pesë çelësat për ushqim më të sigurt

Mbani pastërti

- ✓ Lani duart para përgatitjes së ushqimit dhe sa më shpesh gjatë përgatitjes së tij
- ✓ Lani duart pasi të dilni nga tualeti
- ✓ Lani dhe dezinfektoni të gjitha sipërfaqet dhe pajisjet e përdorura për përgatitjen e ushqimit
- ✓ Mbroni kuzhinën nga insekte e kafshë të ndryshme

Veçoni ushqimet e gatuar nga ato të pagatuara

- ✓ Veçoni mishrat e pagatuara (mishin e kuq, mishin e shpendëve dhe prodhimet e detit) nga ushqimet e tjera.
- ✓ Përdorni pajisje dhe enë të veçanta (thika apo sipërfaqe për prerje), për trajtimin e ushqimeve të pagatuara
- ✓ Ruani ushqimet në enë të veçanta për të shmangur kontaktin midis ushqimeve të gatuar prej atyre të pagatuara

Gatvani mirë

- ✓ Gatvani ushqimin mirë, veçanërisht mishin e kuq, mishin e shpendëve, vezët dhe prodhimet e detit
- ✓ Zieni ushqimet e tilla si supa, gjellërat etj, duke siguruar që të arrijnë temperaturën 70°C. Në rastin e mishit të kuq dhe mishit të shpendëve, sigurohuni që lëngu të jetë pa ngjyrë, jo rozë. Në rastin më të mirë përdorni termometrin
- ✓ Ngrohni përsëri dhe mirë ushqimet e gatuar më parë

Mbani ushqimet në temperatura të sigurt

- ✓ Mos lini ushqimet e gatuar në temperaturën e dhomës për më shumë se dy orë
- ✓ Futni menjëherë në frigorifer të gjitha ushqimet e gatuar apo ato që prishen shpejt (preferohen temperatura nën 5°C)
- ✓ Përpapa servijes, ngrohini ushqimet e gatuar në më shumë se 60°C
- ✓ Edhe në rastin e frigoriferit mos i mbani gjatë ushqimet pa i konsumuar
- ✓ Mos lini të shkrijnë ushqimet e ngrira në temperaturën e dhomës

Përdorni për gatim ujë dhe përbërës bazë të pastër

- ✓ Përdorni ujë të pastër ose ziejini për ta bërë të pastër
- ✓ Zgjidhni ushqime të freskëta dhe të shëndetshme
- ✓ Zgjidhni ushqime të përpunuara nga ana e sigurisë, si p.sh qumësht të pastërtizuar
- ✓ Lajni frutat dhe perimet, veçanërisht nëse do të konsumohen të freskëta
- ✓ Mos i përdorni ushqimet pas datës së skadencës

Njohuri = Parandalim

Food Safety World Health Organization

Komuna e Fushë-Kosovës ndan rreth 335 mijë euro për arsim



FUSHË-KOSOVË, 16 KORRIK - Komuna e Fushë-Kosovës ka bërë me dije se ka ndarë rreth 335 mijë euro për mbështetjen e arsimit. "Drejtoria Komunale për Arsimit në Fushë - Kosovë për ngritjen e cilësisë dhe

mbështetjen e arsimit ndan mbi 334 mijë euro. Bazuar në thirrjen e datës 15 prill 2024 përmes së cilës Komuna e Fushë - Kosovës, konkretisht Drejtoria Komunale për Arsimit ka lansuar thirrjen për

'Mbështetje financiare për studentë'. Nga kjo thirrje DKA ka ndarë shumën mbi 334 mijë euro për kategoritë që kanë qenë të specifikuar në thirrjen e publikuar. Numri i përfutuesve do

të jetë mbi 800. Në ditët në vijim do të publikohen listat dhe shumat për secilën kategori përfutuese nga kjo thirrje", ka njoftuar komuna e Fushë-Kosovës.

Policia vazhdon kontrollin dhe mbikëqyrjen në trafikun rrugor

PRISHTINË, 16 KORRIK - Policia e Kosovës ka njoftuar të martën se është duke vazhduar kontrollin dhe

mbikëqyrjen në trafikun rrugor në tërë territorin e vendit. Kontrolli po bëhet përmes

njësisë me motoçikleta, veturave me radar mobil dhe veturave me pajisje inteligjente. "Kërkojmë nga

pjesëmarrësit respektim të rregullave të trafikut për një siguri më të lartë", ka njoftuar Policia e Kosovës.



MD-ja: Reagimi i KPK-së për miratimin e ligjit të ri, ndërhyrje flagrante në kompetencat e Qeverisë dhe Kuvendit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 KORRIK - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka reaguar ndaj miratimit të Projektligjit për këtë institucion nga ana e Kuvendit të Kosovës, duke thënë se rrezikon pavarësinë prokuroriale.

Në reagim e KPK-së thuhet se Qeveria e Kosovës në vazhdimësi ka injoruar dhe refuzuar komentet, sugjerimet dhe propozimet e përfaqësuesve të deleguar të KPK-së në grupet punuese, të formuara nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe në komisionet e Kuvendit të Republikës së Kosovës për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të ri për KPK-në, i cili është miratuar më 11 korrik 2024.

E lidhur me këtë reagim, Ministria e Drejtësisë ka thënë se shpreh keqardhje. "Ministria e Drejtësisë shpreh keqardhje për reagimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) të datës 15.07.2024 ndaj miratimit të Ligjit nr.08/L-249 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Reagimi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, është në vazhden e qasjes destruktive, veprimeve penguese dhe tendencave të vazhdueshme bllokuese të Këshillit Prokurorial madje është ndërhyrje flagrante në kompetencat e Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ka për qëllim ruajtjen e status quo-s dhe vazhdimin e problemeve sistematike, tanimë të njohura për publikun dhe për të cilat shprehin të gjithë shqetësim. Ashtu si gjatë pjesëmarrjes në grupet punuese të Ministrisë së Drejtësisë, por edhe në diskutimet e fundit dhe amendamentet e shqyrtuara në Komisionin për Legjislacion të

Kuvendit, reagimi i KPK-së nuk përmban as edhe një argument të vetëm se si ky ligj 'cenon pavarësinë e KPK-së', 'ndërhyrje në mandatin kushtetues' apo edhe "pamundëson funksionalizimin e KPK-së", siç pretendohet në reagimin e KPK-së. Reagimi përveçse përmban të pavërteta e pasaktësi faktike, gjithashtu bazohet vetëm në konstatime dhe deklarata të përgjithshme që nuk janë të specifikuar e as argumentuara ligjërisht dhe profesionalisht e cila qasje dhe veprim bie në kundërshtim edhe me vet rolin dhe mandatin e KPK-së për bashkëpunim konstruktiv dhe kontribut profesional në përmirësim të sistemit të drejtësisë, në veçanti atij prokurorial", thuhet në reagimin e kësaj ministrie.

Më tej theksohet se Ligjit për Këshillin Prokurorial i ka paraprirë një procedurë e gjatë e hartimit e cila ka përfshirë konsultimin formal tri herë me Komisionin e Venedikut, diskutime e propozime konkrete nga organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë, propozime dhe diskutime nga vetë përfaqësuesit e sistemit prokurorial si dhe nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës së fundmi. "Pra, ndryshe nga konstatimet e pavërteta dhe aspak të qëndrueshme të Këshillit Prokurorial për qasje të njëanshme, refuzim dhe injorim të propozimeve e komenteve të përfaqësuesve të tyre, Ministria e Drejtësisë rithekson se në vazhdimësi ka ftuar përfaqësuesit e sistemit prokurorial në takimet e grupit të gjerë punues, por edhe në takimet e veçanta, duke trajtuar kështu secilin propozim të tyre dhe duke adresuar dhe pranuar të gjitha ato që janë në interes të vet reformës.

Rrjedhimisht, Kuvendi i



Republikës së Kosovës, pas një procesi gjithëpërfshirës (përfshirë përfaqësuesit e sistemit prokurorial), ka miratuar një Ligj reformues për sistemin, në përputhje të plotë me opinionet e Komisionit të Venedikut dhe Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese së vitit të kaluar për këtë çështje.

Ndryshe nga konstatimet e Këshillit Prokurorial, miratimi i nismës së tillë, ishte mirëpritur nga vet akterët pjesëmarrës në këtë reformë siç janë përfaqësuesit aktiv të shoqërisë civile dhe të tjerë dhe i cili fakt,

nuk kishte nxitur reagimin kundërshtues të shumicës së partnerëve ndërkombëtarë pjesëmarrës në këtë nismë (përfshirë atë të zyrës së BE-së që ka të bëjë me kërkesën e tyre për dërgim të serishëm në Komisionin e Venecias dhe adresim të rekomandimeve që kanë të bëjnë me komisionin parazgjedhor, për të cilat, Ministria e Drejtësisë së bashku me Komisionin për Legjislacion, kishin ofruar sqarimet e nevojshme)", bëhet me dije në reagimin e MD-së.

Si rrjedhojë, Ministria e Drejtësisë

i bën thirrje KPK-së të fokusohet në zbatimin e këtyre elementeve që janë në të mirën e vet sistemit dhe të cilën reformë publiku, së bashku me reformat e tjera, e pret nga institucionet të cilat janë të mandatuara për të garantuar sundim të ligjit, ofruar drejtësi e mbrojtur të drejtat e njeriut. "Ministria e Drejtësisë kërkon nga Këshilli Prokurorial i Kosovës që të braktisë qasjen destruktive dhe tendencat penguese dhe të jetë një partner bashkëpunues me qëllim të jetësisimit të plotë të reformës në drejtësi", është thënë tutje në reagimin e MD-së.

E plagosi aksidentalisht në kokë familjarin 16-vjeçar, arrestohet dhe suspendohet nga puna polici në Istog



PRISHTINË, 16 KORRIK - Një incident me armë zjarri ka ndodhur pas mesnate në fshatin Dubravë të Istogut. Një polic e ka qëlluar aksidentalisht një të mitur familjar në kokë. Lidhur me rastin ka reaguar edhe Inspektorati Policor i Kosovës, i cili konfirmon se i mituri është plagosur në kokë. "Sot pas mesnatës Inspektorati Policor i Kosovës ka pranuar një informacion nga Policia e Kosovës se ka ndodhur një incident me armë zjarri në fshatin Dubravë të Istogut ku një person ishte plagosur në kokë. Hetuesit e IPK-së menjëherë i

janë përgjigjur thirrjes kurse në vendin e ngjarjes kanë dalë edhe njësitet përkatëse policore si dhe prokurori kujdestar. Personi i plagosur në këtë rast (i moshës 16 vjeçare i cili ka lidhje familjare me policin) është dërguar me urgjencë për trajtim mjekësor fillimisht në Spitalin Rajonal të Pejës e pastaj është dërguar në QKUK në Prishtinë", ka njoftuar Inspektorati Policor i Kosovës. Sipas IPK-së, bazuar në hetimet preliminare fillestare, dyshohet se rasti ka ndodhur në shtëpinë e zyrtarit policor i cili deri në këtë fazë të hetimit dyshohet se aksidentalisht ka shkreputur armën

zyrtare. "Personi i dyshuar në këtë rast (zyrtari policor) është arrestuar nga Inspektorati Policor me dyshimin se i njëjti ka kryer veprën penale 'vrasje e mbetur në tentativë' kurse me vendim të prokurorit të njëjtit i është caktuar masa e ndalimit për 48 orë si dhe është suspenduar nga detyra. Hetuesit e IPK-së së bashku me njësitin e forenzikës, njësinë rajonale të hetimeve dhe njësi të tjera do të ndërmarrin veprimet e nevojshme hetimore në vendin e ngjarjes ku ka ndodhur incidenti në konsultim të vazhdueshëm me prokurorin përgjegjës", ka njoftuar IPK-ja.

Qeveria e Kosovës lanson projektin për investime nga mërgata

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 KORRIK - Qeveria e Kosovës, në bashkëpunim me Fondin Kosovar për Garanci Kreditore dhe Agjencinë e ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), lansoi projektin "Dritarja për Investime të Diasporës", i cili synon të sjellë investime të mërgatës në Kosovë. "Po krijojmë mundësi që ta shndërrojmë mërgatën nga investitor pasiv, në investitor aktiv", tha kryeministri Albin Kurti gjatë lansimit të projektit të martën në Prishtinë. Përmes këtij projekti, tha ai, mërgata do ta ketë më të lehtë aplikimin për kredi për investime në Kosovë. "Do të mundësohet garantimi i kredive investuese deri në 3 milionë euro, ndërsa e tërë dritarja parashihet të arrijë deri në 100 milionë euro. Mërgata jonë do t'i sjellë aftësitë, mundësitë dhe kulturën e punës nga vendet ku jeton aktualisht", tha Kurti. Derisa nuk u dhanë shumë detaje

se kur do të nisë projekti dhe për sa kohë do të jetë i hapur, ministri i Financave, Hekuran Murati, tha se "ideja ka qenë që të krijohet një dritare e re, përmes së cilës Fondi për Garanci Kreditore, i mbështetur me kapital shtesë nga Qeveria e Kosovës, do ta mundësojë garantimin e kredive". Në lansimin e projektit ishte i pranishëm edhe ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Jeffrey Hovenier, i cili tha se ai do t'i sjellë në vend praktikata më të mira nga diaspora. "Qeveria amerikane është krenare që ka ndihmuar në themelimin e këtij programi të ri përmes mbështetjes financiare dhe teknike të USAID-it, sepse ne e kuptojmë mundësinë e rrallë që bizneset nga diaspora paraqesin. Kur diaspora kthehet në vend, ajo sjell më të mirën në Kosovë", tha Hovenier.

Numri i saktë i qytetarëve të Kosovës që jetojnë jashtë vendit nuk dihet ende, por pritet të qartësohet në fund të vitit, kur të publikohen të dhënat



përfundimtare të regjistrimit të popullsisë që u bë në pranverë. Diaspora e Kosovës luan rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit përmes dërgimit të

remitencave, investimeve në patundshmëri dhe shpenzimeve që bën gjatë pushimeve në Kosovë. Në vitin 2023 remitencat apo dërgesat financiare të

mërgimtarëve në Kosovë kaluan shifrën prej 1.3 miliard eurosh, ndërsa në vitin 2022 vlera e remitencave ishte 1.22 miliard euro.

Krijohet Fondi i Përbashkët Përshpejtues i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm për Kosovën

PRISHTINË, 16 KORRIK - Në takimin e së martës në mes të zëvendëskryeministrit të parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog të Kosovës, Besnik Bislimi dhe koordinatores rezidente të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Arnhild Spence, u zyrtarizua krijimi i Fondit të Përbashkët Përshpejtues të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm për Kosovën.

Fondi po themelohet me qëllim të avancimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në linjë dhe me realizimin e Agjendës 2030.

Kontributi fillestar në këtë fond do të jetë i Kosovës në shumën e 200 mijë eurove. Fondi në vazhdimësi mund të rritet varësisht prej prioriteteve të përcaktuara dhe në shërbim të përmblotjes së objektivave të parapara, të cilat lidhen me uljen e shkallës së varfërisë, rritjen e kapacitetit të energjisë së ripërtëritshme, transformimin digjital, si dhe



ndërmarrjen e reformave të rëndësishme në sistemin arsimor. Fondi do të pranojë dhe

kontribute nga donatorë e partnerë, teksa ndaj çdo financimi shtesë nga donatorët qeveria do të

kontribuojë në vlerën prej 20 % të shumës. Zëvendëskryeministri Bislimi

theksoi përkushtimin e qeverisë për përmblotjen e OZhQ-ve dhe zbatimin e Agjendës 2030, me fondin si faktor shtesë shtytës dhe katalizator. "Ne besojmë se angazhimi ynë në krijimin e këtij Fondi do të kontribuojë edhe më tej në përpjekjet drejt krijimit të një shoqërie të barabartë për të gjithë, përmes arritjes së objektivave për zhvillim të qëndrueshëm të cilat janë të pasqyruara edhe në Strategjinë tonë Kombëtare për Zhvillim", u shpreh zëvendëskryeministri Bislimi gjatë takimit.

Spence e përshëndeti vendimin e qeverisë për themelimin e këtij fondi bashkë me kontributin fillestar, duke shtuar se krijimi i tij dëshmon angazhimin e përbashkët për t'i adresuar sfidat komplekse të zhvillimit të qëndrueshëm. Në përfundim, palët shprehën gatishmërinë për bashkëpunim të ngushtë në rrugën përpara drejt realizimit të OZhQ-ve dhe agjendës 2030.

KESCO importon 1 milion euro energji elektrike në ditë

PRISHTINË, 16 KORRIK - KESCO ka njoftuar se për ta mbuluar kërkesën e rritur për energji elektrike është duke importuar çdo ditë rreth 1 milion euro energji elektrike.

Sipas KESCO-s, deri te kjo situatë ka ardhur pasi gjatë këtyre ditëve situata elektroenergetike është vështirësuar tej mase nga disa faktorë. "Fillimisht është rritur kërkesa si pasojë e temperaturave ekstreme të ngrohta që po mbizotërojnë në vendin tonë, duke bërë që kërkesa në kohë piku të kalojë

mbi 800 megavate, dukshëm mbi mesataren e kësaj periudhe, për shkak të përdorimit masiv të kondicionerëve anekënd Kosovës. Në rëndimin e situatës po ndikon edhe fakti që njësjia B1 e KEK-ut është në remont të planifikuar vjetor, duke bërë që prodhimi vendor të reduktohet së paku 250 MW. Pra, aktualisht Kosova nuk po prodhon më tepër se 500 MW, ndërsa diferenca ndërmjet prodhimit dhe kërkesës po mbulohehet nga importi. Edhe çmimet e importit janë rritur shumë ditët e fundit. Në berëzat e rajonit

tonë çmimet po sillen mbi 200 euro për megavat. Kjo po e vështirëson shumë situatën pasi duhet blerë energji nga jashtë me kosto të shtuar", ka njoftuar KESCO. Megjithatë, KESCO ka theksuar se mbetet e përkushtuar t'i furnizojë konsumatorët pa ndërprerje me energji elektrike. "Por, kërkon nga të gjithë që ta kursejnë maksimalisht energjinë elektrike, si një produkt që është jetik për të gjithë, sidomos në kohën e kushteve ekstreme atmosferike", ka njoftuar KESCO.



Zelenski: Rusia duhet të marrë pjesë në bisedimet për paqe

Presidenti ukrainas Zelenski tha se Kievi mund të ftojë një delegacion rus për një samit të dytë për paqe. Sipas një sondazhi të mediave ukrainase mbi 40% e ukrainasve mbështesin fillimin e bisedimeve të paqes.

Presidenti ukrainas Volodimir Zelenski tha se qeveria e tij synon të përgatisë deri në nëntor një plan paqeje për një samit të dytë ndërkombëtar për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë. Ukraina zhvilloi muajin e kaluar një samit në Zvicër, në të cilin morën pjesë përfaqësues të 92 vendeve, por jo të Rusisë.

"Unë mendoj se përfaqësuesit e Rusisë duhet të jenë të pranishëm në samitin e dytë," tha Zelenski tha pasi u kthye nga një vizitë në Uashington, ku mori pjesë në samitin e NATO-s. Rusia kishte kritikuar më parë samitin e mbajtur në Zvicër, duke thënë se çdo diskutim që nuk përfshin Moskën është "absurd".

Mbi 40% e ukrainasve janë pro fillimit të bisedimeve për paqe me Moskën

Sipas një sondazhi të botuar nga e përjavshmja ukrainase

Dzerkalo Tyzhnia mbi 40 për qind e ukrainasve janë pro fillimit të negociatave për paqe me Rusinë.

Në sondazh nuk ishin përfshirë banorët e Gadishullit të Krimesë, i cili u aneksua ilegalisht nga Rusia në vitin 2014, dhe zona të tjera në lindje dhe jug të vendit që janë të kontrolluara nga Rusia.

Mbi 40% e ukrainasve janë pro fillimit të bisedimeve për paqe me Moskën

Sipas sondazhit 43.9% e ukrainasve në zonat e kontrolluara nga Kievi mendojnë se "ka ardhur koha për fillimin e bisedimeve zyrtare për paqe midis Ukrainës dhe Rusisë", 35% ishin kundër fillimit të negociatave dhe 21% që ishin të pavendosur.

Dallime rajonale

Në rajonet jugore të Ukrainës u konstatua mbështetja më të madhe për fillimin e bisedimeve të paqes, me rreth 60%. Ndërsa në rajonet qendrore pro negociatave ishin gati gjysma e



banorëve.

Në perëndim të vendit – që konsiderohet si qendra ku jeton popullsia ukrainisht-folëse, e cila tradicionalisht ka votuar për partitë nacionaliste dhe properëndimore ukrainase – pro fillimit të bisedimeve të paqes me Moskën ishte vetëm 35% e popullsisë.

Mbështetja më e ulët për negociatat u regjistrua në rajonet lindore të Ukrainës, ku pro bisedimeve ishte vetëm 34% e popullsisë.

Shumica e të anketuarve kundër propozimeve të Putinit

Megjithë qëndrimin pro bisedimeve për paqe 83% e të anketuarve janë kundër kërkesave të bëra në qershor nga presidenti rus Vladimir Putin në mënyrë që t'i jepet fund luftës. Putini tha se Rusia do të binte dakord për armëpushim dhe do të hynte në bisedime për paqe, nëse Ukraina do të tërhiqte

trupat e saj nga katër rajone në jug dhe lindje që Moskë pretendon se i ka aneksuar. Nga katër rajonet e pretenduara vetëm Luhansku kontrollohet kryesisht nga forcat ruse.

Presidenti rus kërkoi gjithashtu që Kievi të heqë dorë nga çdo ambicie për t'u anëtarësuar në NATO. Sipas sondazhit thuajse 59% e popullsisë janë kundër përfshirjes në kushtetutën e Ukrainës të një neni për neutralitet dhe mosangazhimin ushtarak të vendit./ DW

"Duhet të dimë çfarë ka në mendje Zelensky", Peskov: Dorëzim pa kushte i Kievit



Rusia nuk kërkon paqe me Ukrainën, por vetëm dorëzim të plotë dhe pa kushte për Kievi. Ky është përfundimi i analizës studimore të bërë nga Instituti për Studimin e Luftës me qendër në Shtetet e Bashkuara.

Ukraina, sipas "Think-Tank"-ut amerikan, vazhdon të demonstrojë gatishmërinë e saj për të negociuar me Rusinë sipas kushteve të saj, me kërkesat për një marrëveshje paqeje në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Po ashtu, qendra studimore amerikane kujton se dje Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se ishte në favor të pjesëmarrjes së Rusisë në samitin e ardhshëm të paqes.

Megjithatë, theksojnë ekspertët, deklaratat e fundit nga Kremli vazhdojnë të tregojnë se Rusia është jofleksibile në negociata dhe nuk do të marrë pjesë në një samit të dytë të paqes sepse kushtet e tij nuk janë të pranueshme duke pasur parasysh kërkesat e Moskës. Për sa i përket mbajtjes së një tjetër samiti paqeje nga Volodymyr Zelensky, ka reaguar edhe Kremli. Sipas zëdhënësit Dmitry Peskov,

"samiti i parë i paqes nuk ishte aspak një samit i paqes, kështu që ne duhet të kuptojmë se çfarë ka në mendje" Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky kur flet për një samit të dytë të paqes. Reagimin e tij, Peskov e bëri për agjencinë ruse të lajmeve Tass.

Sakaq, raketa dhe dronë janë lëshuar nga Ukraina mbi rajonet ruse. Mediat ndërkombëtare bëjnë me dije se sistemet e mbrojtjes ajrore të Moskës shkatërruan 13 dronë ukrainas, 9 prej të cilëve mbi rajonin e Rostovit. Në rajonin e Kurskut, një fabrikë pajisjesh mori flakë pas një sulmi me dron ukrainas. Fabrika e Pajisjeve Elektrike Kursk është një nga prodhuesit më të mëdhenj të produkteve elektrike në Rusi.

Goditja e rajoneve ruse është përkrahur nga Ministri i Jashtëm i Ukrainës, i cili kërkoi që të shkatërrohen bombarduesit rus përpara se ushtria ruse të hedhë bomba ajrore të drejtuara vdekjeprurëse mbi pozicionet, qytetet dhe komunitetet e Ukrainës, vuri në dukje zyrtari i lartë ukrainës, Dmitr Kuleba.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Gareth Southgate jep dorëheqje nga kombëtarja e Anglisë

LONDËR, 16 KORRIK - Gareth Southgate nuk do të jetë më trajner i ekipit të kombëtares së Anglisë. 53-vjeçari ka dhënë dorëheqje nga kombëtarja dy ditë pas

finale së humbur me Spanjën në Euro 2024. Lajmin e ka dhënë trajneri anglez. "Si një anglez krenar, ka qenë nderi i jetës sime të luaja për Anglinë dhe ta

drejtoja Anglinë. Ka qenë gjithçka për mua dhe kam dhënë gjithçka. Por, është koha për ndryshim dhe për një kapitull të ri. Finalja e së dielës ishte ndeshja e fundit

si trajner i Anglisë", ka deklaruar 53-vjeçari. Southgate ka drejtuar Anglinë në 120 ndeshje zyrtare dhe ka qëndruar në stol prej tetë vitesh.



Ekipi olimpik i Kosovës pranon flamurin shtetëror për Lojërat Olimpikë Paris 2024



PRISHTINË, 16 KORRIK - Sportistët që do ta përfaqësojnë Kosovën në Lojërat Olimpikë Paris 2024 kanë pranuar flamurin shtetëror nga presidentja Vjosa Osmani. Në platenë e Amfiteatrit të Gërmisë, ku u mbajt ceremonia zyrtare e dorëzimit të flamurit, ishin të pranishëm edhe kryeministri Albin Kurti, ministri Hajrulla Çeku, zëvendësministria Daulina Osmani, presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, trajneri Driton Kuka, ambasadorë të akredituar në vendin tonë,

trajnerë, drejtues të federatave sportive, sportistë dhe sportdashës. Fjalë rasti mbajtën presidentja Osmani, kryeministri Kurti, ambasadori i Francës Olivier Guerot, presidenti i KOK-ut, Krasniqi dhe kampionia botërore dhe evropiane e xhudos, trajnerja Majlinda Kelmendi. Nga fjalimet e tyre u tha se ky është një moment historik për Kosovën, që edhe në këtë olimpiadë Paris 2024 po merr pjesë me një super ekip dhe me super sportistë, duke theksuar se

përfaqësimi i republikës sonë është përgjegjësi që kërkon përqendrim profesional dhe atdhedashuri njerëzore. Kosova do të përfaqësohet në Lojërat Olimpikë Paris 2024 me nëntë sportistë. Gjashtë është numri i sportistëve të kualifikuar, pesë nga xhudo dhe një nga boksi, si dhe tre sportistë me ftesë të univerzalitetit, dy nga noti dhe një nga atletika. Lojërat Olimpikë do të mbahen nga data 26 korrik deri më 11 gusht 2024.

Shqiptari nga Kroacia me Agjencinë "Niagara Sport Company", ndër dhjetë menaxherët më të mirë në botë për transferime të futbollistëve

PRISHTINË, 16 KORRIK - "Në Kosovë lajmi i mirë si duket nuk është lajm. Depërtojnë vetëm ato lajme negative që lënë gjurmë negative në aspektin moral, etik, psikologjik dhe në aspektin motivues! Se diaspora jonë është ambasadorja shpirtërore që po promovon dhe mbështet Kosovën po bindemi çdo ditë e më shumë. Jo vetëm në sport, muzikë, art, por edhe në aspektin e ndërmarrësisë dhe biznesit ndërkombëtar po dëshmohet çdo ditë dhe po e përmirëson imazhin e Kosovës", ka shkruar në "Facebook" njohësi i ekonomisë, Safet Gërxhaliu. Ai ka thënë se Andy Bara është

një storie e suksesit. Me agjencinë për transferimin e futbollistëve "Niagara Sports Company" është në top dhjetë agjencitë e botës. "Niagara Sports Company" është themeluar në vitin 2013 në Madrid dhe sot operon me sukses në Zagreb, Milano, Dubai dhe Rio de Janeiro të Brazilit. "Në këtë kohë të konkurrencës së madhe në këtë fushë, ku vetëm në Angli janë më shumë se 13 000 agjentë për transferim të lojtarëve e të gjendeni në top 10 agjencitë e botës, besoj se dëshmon suksesin e Andy Bares. Babai i tij është nga Vushtrria e Kosovës", ka thënë Gërxhaliu.



TOP 10 AGENCIES							
BEST PLAYER PERFORMANCES UCL							
AGJENCIA	LOJTARË	GOLA	ASISTENCA	VALORI	VALORI	VALORI	
1	CESTIFITE	36	13	26	14,312	143,000,000	
2	ROOF	16	8	11	6,036	251,300,000	
3	ROC NATION SPORTS	4	18	18	1,864	340,000,000	
4	CAA STELLAR	28	6	11	17	4,741	489,000,000
5	ELITE PROJECT GROUP LIMITED	6	7	13	1,837	336,000,000	
6	CKEEL LIMITED	1	9	4	13	1,648	110,000,000
7	BERTOLUCCI SPORTS	7	5	10	3,852	271,000,000	
8	RAFAELA PINETA	4	6	3	9	2,616	251,000,000
9	CAA BASE LTD	13	5	4	9	4,018	214,000,000
10	NIAGARA SPORTS COMPANY	6	4	3	9	2,148	89,000,000

Ai ka shtuar se sot Andy Bara dhe agjencia e tij "Niagara Sports Company" menaxhon emra të njohur të futbollit si Dani Olmo, Alvaro Morata, Lovro Majer, Alvaro Djalo, Jonathan Ikone, Mikayil Faye, Jorge de Frutas, Nacho Fernández, Keide Bare, Joanmi Latasa, Ruben Vanez, Muhammad Bouldini dhe shumë emra të tjerë të futbollistëve. "Të mësojmë nga sukseset e të rinjve shqiptarë dhe t'u gëzohemi suksesëve të tyre, sepse ato suksese promovojnë më së miri Republikën e Kosovës në këto kohë të sfidave të shumta me të cilat po ballafaqohet", ka shkruar Safet Gërxhaliu.

Kylian Mbappe, zyrtarisht lojtar i Real Madridit



MADRID, 16 KORRIK - Superylli i futbollit, Kylian Mbappe, është zyrtarisht martë lojtar i Real Madridit. Presidenti i klubit, Florentino Perez, e ka mirëpritur lojtarin në sallën e këshillit të "Real Madrid

City", ku sulmuesi francez ka nënshkruar kontratën që do ta angazhojë atë në klub për pesë sezonet e ardhshme. Pas nënshkrimit, Mbappes i është dhuruar një kopje e stadiumit, një orë dhe një fanellë me emrin e tij

dhe numrin 9 të shtypur në të. Ai është mirëpritur në "Santago Bernabeu" nga 85 mijë tifozë të Realit. Mbappe është golashënuesi më i mirë i të gjitha kohëve të Paris Saint-Germaini me 256 gola. Këtë

sezon ai ka fituar titullin e ligës, Kupën e Francës dhe Superkupën e Francës. Në shtatë vjet në PSG, ai ka grumbulluar 17 trofe: Ligën (6), Kupën e Francës (4), Superkupën e Francës (5) dhe Kupën e Ligës (2).

Hyseni dhe zëvendësministria Osmani bisedojnë për përgatitjet e Lojërave Mesdhetare 2030

GJILAN, 16 KORRIK - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka pritur në takim zëvendësministren e Kulturës, Rinisë e Sportit, Daulina Osmani.

Tema të bisedës ishin sfidat e ndryshme për kulturën, rininë e sportin, posaçërisht përgatitjet për Lojërat Mesdhetare 2030. "Kisha nderin të pres për takim

zëvendësministren e MKRS-së, Daulina Osmani", tha Alban Hyseni. Kryetari i Gjilanit tregoi se bashkëbiseduan për projektet e përbashkëta dhe detyrat që

kanë përpara, si përgatitjet për Lojërat Mesdhetare 2030. "Bashkë me Qeverinë e Kosovës po angazhohemi maksimalisht që të arrihen të gjitha objektivat", tha kryetari Hyseni.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Auto Pjesë MB Selimi" Sh.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812083210 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Auto Pjesë MB Selimi" D.O.O. od Gjilane, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812083210 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Auto Pjesë MB Selimi" L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812083210 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Thirrja për aplikim (DHËNJE TË OFERTËS)

"AGRO Vëllezërit Uka" SH.P.K. **me Numer Unik.Biz:** 812177683 me seli te biznesit në Adresa: RR. " Gani Uka", nr 84 Tice, **komuna Skenderaj**, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për **mallrat/punët/shërbime** këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Makinerive dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:

- 1. Traktor me luge,**
- 2. Rimorkioa per Shprendarese e plehut organik,**
- 3. Makine mbjellese per miser,**
- 4. Kose rotative me 5 pjata,**
- 5. Rrotoballer,**
- 6.Energjia Solare.**

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek "AGRO Vëllezërit Uka" SH.P.K. **pronar Mehmet Uka** (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë **(5 ditë nga data e publikimit)**

Afati i dorezimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit te ftesave** per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: RR. " Gani Uka", nr 84 Tice, **komuna Skenderaj**
Për Informata Shtesë tel: +38344195374

dhe në email adresën: mehmet.uka2024@gmail.com



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156



+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ben Islami shpall të humbur Çertifikaten e Regjistrimit për TVSH me numer serik: 3012613 si dhe numeri biznesi nrb: 70104645
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

